



## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Beqir Kalludra, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Ahmeti, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit K.V. nga Prishtina, për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të pandehurit, avokatit Shpend Bokshi, të datës 22 shtator 2020, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1504/2020, të datës 28 gusht 2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 12 janar 2021, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të të pandehurit, avokatit Shpend Bokshi, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.1504/2020, i datës 28 gusht 2020 (aktgjykimi i ankimuar), vetëm sa i përket dënimeve të shqiptuara, ashtu që kolegjii penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, të pandehurit K.V., për shkak të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 700 € (shtatëqind Euro), të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë brenda afatit të lartcekur, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që 1 (një) ditë burgim do të barazohet me 20 € (njëzet Euro) të dënimit me gjobë.

Në pjesët tjera, aktgjykimi i ankimuar mbetet i pandryshuar.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin K.V. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 paragrafi 1, nën-

paragrafi 1.1. të KPRK dhe ndaj të njëjtit për shkak të kësaj veprë penale është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 1000 € (njëmijë Euro), të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri refuzon apo nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë i njëjti me pajtimin e të pandehurit mund t'i zëvendësohet në punë për dobi të përgjithshme. E nëse i pandehuri nuk pajtohet as me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë për dobi të përgjithshme, atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet Euro) të dënimit me gjobë do t'i caktohet nga 1 (një) ditë burgim.

Në dënimin e shqiptuar me burgim, të pandehurit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 31 korrik 2020 deri sa ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, në atë mënyrë që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet me 1 (një) ditë burgim.

Të pandehurit me aktvendim të veçantë i është vazhduar paraburgimi deri në ditën kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Të dëmtuarat M.K. dhe S.K. nga Prishtina, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Është detyruar i pandehuri që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30 € (tridhjetë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë mbrojtësi i të pandehurit, avokati Shpend Bokshi, për shkak të vendimit mbi dënimin, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ta aprovoj ankesën, ndërsa ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, ashtu që të pandehurit t'i shqiptohet një dënim dukshëm më i vogël konform dispozitës së nenit 71, pika 1.3. të KPRK ose lëndën ta kthej në rivendosje.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.992/2020, të datës 8 dhjetor 2020, ka propozuar që të anulohet aktgjykimin i ankimuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim, ndërsa ankesa e mbrojtësit të të pandehurit të trajtohet si jo lëndore.

Në ankesën e mbrojtësit të të pandehurit, avokatit Shpend Bokshi, theksohet se dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit janë tepër të larta, pasi që në rastin konkret sendet e vjedhura u janë kthyer të dëmtuarave dhe nuk kemi një vlerë të madhe të sendeve që janë vjedhur, gjë e cila nuk është vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Me rastin e matjes së dënimeve, gjykata e shkallës së parë e ka marrë për bazë vetëm një rrethanë lehtësuese, faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale, mirëpo nuk është marrë për bazë edhe fakti se i pandehuri është i gjendjes skajshmërisht të varfër, se nuk ka familje, se jeton i vetëm dhe nuk ka adresë të qëndrueshme, kështu që si i tillë

është edhe problem social, e cila edhe të njëjtin e ka shtyrë që të kryej vjedhjen. Andaj, edhe në këtë mënyrë në rastin konkret kemi vetëm rrethana lehtësuese e asnjë rrethanë rënduese. Duke u bazuar në këto që u thanë më lart, gjykata e shkallës së parë është dashur që ta zbatoj nenin 71 paragrafi 1.3. të KPRK, në atë mënyrë që të pandehurit t'i shqiptoj një dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo t'i shqiptoj një dënim më të butë.

Gjykata e Apelit e Kosovës e ka caktuar dhe mbajtur seancën e kolegjit konform nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), në të cilën seancë kanë marrë pjesë të dëmtuarat M. dhe S.K., i pandehuri K.V. dhe mbrojtësi i tij, avokati Shpend Bokshi, ndërsa në këtë seancë nuk ka marrë pjesë prokurori i Prokurorisë së Apelit të Kosovës edhe përkundër faktit se është njoftuar në mënyrë të rregullt.

Të dëmtuarat M. dhe S.K. gjatë seancës së kolegjit kanë deklaruar se i bashkëngjiten ndjekjes penale, por nuk kanë parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të pandehurit, avokati Shpend Bokshi gjatë seancës së kolegjit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesë, ndërsa i pandehuri K.V. e ka përkrahur deklarin e mbrojtësit të tij, duke shtuar se i vjen keq dhe është penduar për kryerjen e veprës penale.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të KPP, konstaton se :

- me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të të pandehurit, duhet që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar vetëm sa i përket dënimeve të shqiptuara, siç është cekur më lart.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstaton se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të pandehurit K.V..

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të mbrojtësit të të pandehurit janë të bazuara për faktin se dënimet e shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë janë me të vërtetë dënime të ashpra, duke i pasur parasysh rrethanat e rastit konkret. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimeve nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha rrethanat e rastit konkret, përkatësisht janë nënvlerësuar rrethanat lehtësuese të cilat kanë qenë prezente me rastin e marrjes së aktgjykimit të ankimuar. Në këtë drejtim, siç rezulton edhe nga aktgjykimi i ankimuar, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimeve e ka marrë për bazë si rrethanë lehtësuese vetëm pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, mirëpo nuk janë marrë për bazë edhe shumë rrethana tjera

lehtësuese të cilat të ndërlihdura së bashku e arsyetojnë shqiptimin e dënimeve më të buta dhe atë nën kufirin e parashikuar me ligj për veprën penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konsideron që përveç pranimit të fajësisë, gjykata e shkallës së parë është dashur që ta marrë për bazë si rrethanë lehtësuese me rastin e matjes së dënimeve edhe faktin se sendet e vjedhura u janë kthyer palëve të dëmtuara, gjë që mund të shihet edhe nga vërtetimi mbi kthimin e gjësendeve i datës 31 korrik 2020, i përpiluar nga ana e zyrtarëve të Policisë së Kosovës. Përveç kësaj, nuk është vlerësuar edhe fakti se nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet nëse i pandehuri më parë ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale, pavarësisht faktit se nga shkresat e policisë shihet që ndaj tij janë iniciuar edhe procedura tjera penale, mirëpo nuk kemi ndonjë aktgjykim të formës së prerë në shkresa të lëndës. Gjithashtu, nga vet deklarimi i të pandehurit në lidhje me pranimin e fajësisë që në fazat e hershme të procedurës penale, por edhe nga deklarimi i tij gjatë seancës së kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës shihet që i njëjti ndjen keqardhje për rastin e ndodhur dhe ka deklaruar se është penduar për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar, duke shtuar se është në një gjendje të rëndë ekonomike. Ndërsa, në anën tjetër të dëmtuarat nuk kanë paraqitur ndonjë kërkesë pasurore juridike për dëmin e shkaktuar, duke pasur parasysh se siç është cekur edhe më lart, të njëjtave u janë kthyer sendet që i kishte vjedhur i pandehuri. Andaj duke u bazuar në këto që u thanë më lart, si dhe duke i pasur parasysh edhe rrethanat tjera personale dhe familjare të të pandehurit (mungesës së përkujdesjes familjare), kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës ka ardhur në përfundim se ndaj të pandehurit duhet të shqiptohen dënime më të buta, pasi që në rastin konkret janë plotësuar të gjitha konditat ligjore që ndaj tij të aplikohet neni 71 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPRK që i referohet zbutjes së dënimit. Në këtë mënyrë, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës ka vendosur që ndaj të pandehurit K.V., për shkak të veprës penale për të cilën ishte akuzuar, të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 700 € (shtatëqind Euro), siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se dënimet e tilla janë dënime të drejta, të ligjshme, në harmoni me peshën e veprës penale, me cilësitë personale të të pandehurit, gjendjen ekonomike dhe familjare të të pandehurit, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës është i bindur se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 38 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart e në bazë të nenit 398 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
Departamenti i Përgjithshëm  
PA1.nr.979/2020, më datën 12 janar 2021

Bashkëpunëtori profesional,  
Bujar Ahmeti

---

Anëtarët e kolegjit:  
Afrim Shala

---

Beqir Kalludra

---

Kryetar i kolegjit,  
Hashim Çollaku

---